



02/Nr. 560  
Data: 20.01.2023

## PROCESVERBAL I PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2023

Procesverbali nga Plani i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023, të mbajtur me datën 21.12.2022, duke filluar nga ora 15:00 në Sallën e Takimeve në katin I në objektin e Komunës me gjithsej 41 pjesëmarrës/e. Për prezentimin e Raportit, prezent ishte **Mehmet Ballazhi** (Kryetari i Komunës), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës së Përgjithshme), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor përbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoresh e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik) dhe **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), nga Kabineti, zyrtarë të drejtorive përkatëse, si dhe qytetarë nga Hani i Elezit me rrethinë.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës z. **Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin publik mbi raportin e punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 dhe theksoi se ky raport do të prezantohej shkurtimisht nga ai pasi që materiali i plotë ishte shpërndarë të pranishmit, dhe për të plotësuar do të jenë të gatshëm drejtorët/et komunale.

Me këtë rast, Kryetari falënderoi në veçanti zyrtarët komunalë që kanë qenë të drejtëpërdrejtë në kryerjen e punëve duke arritur rezultate, si pasojë e bashkëpunimit të mirë mes stafit ekzekutiv dhe stafit civil.

### RENDI I PUNËS

#### 1. Plani i punës së Kryetarit për vitin 2023.

- **Mehmet Ballazhi thekson:** Rëndësia e debatit publik mbi Planin e punës së Kryetarit për vitin 2023 është i rëndësishëm sepse ky plan shkon për votim në Kuvend dhe nëse dikush nga ju jep ndonjë propozim për diçka konkrete, ne mund ta inkuadrojmë në planin tonë qeverisës për 2023. Atëherë, disa nga fushat si prioritetet e mia të programit qeverisës për vitin 2023 janë: shërbimi ndaj qytetarëve, ngritja i shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale, rregullimet infrastrukturore dhe urbanistike, arsimi familja dhe siguria, zhvillimi ekonomik i qytetit, ku aktivitetet drejt arritjes së objektivave do të bëhen nga stafi i kabinetit, drejtoritë përkatëse, stafi i drejtorive dhe zyrat përgjegjëse.

Në vazhdim po ju paraqes objektivat për vitin 2023:

- Stimulim i nxënësve për regjistrim në shkollat profesionale me mbulim të shpenzimeve të udhëtimit dhe studentëve të suksesshëm me bursa studetore,
- Trajtimi i barabartë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe skemës sociale,
- Menaxhim cilësor dhe efektiv të buxhetit të komunës për vitin 2023,
- Vazhdim i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, Qeverinë, IKSHPK, QKMF.

- Transparençë digjitale për të gjitha aktivitetet në komunë dhe shpenzimet buxhetore
- Krijimi i kushteve optimale për punë në çerdhen e fëmijëve,
- Vazhdim i përkrahjes së intucioneve dhe aktivitetëve kulturore dhe sportive,
- Vazhdim i rritjes së shërbimeve në QKMF dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët,
- Realizimi cilësor i të gjitha projekteve të planifikuara,
- Miratimi i PZHK-së dhe harta zonale e komunës,
- Informimi i qytetarëve dhe përkrahja për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas ligjit për legalizime,
- Përmbyllja e projektit CDI-KOMUNË-KRU “BIFURKACIONI” për rehabilitimin e Fabrikës së ujit në prrockë të Dimcës si dhe vënia nën kontroll të ujit të pijshëm në Han të Elezit,
- Inkurajimi dhe mbështetja e qytetarëve për zhvillimin e aktivitetëve biznesore dhe përkrahja për hapje të bizneseve të reja,
- Vazhdimi i përkrahjes dhe stimulimi i fermerëve përmes subvencioneve,
- Bashkëpunim me komuna të ndryshme duke përfutur nga eksperiencia e tyre dhe shembujt pozitiv,
- Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar me komuna ,
- Bashkëpunim me institucione shtetërore, OJQ dhe institucione ndërkombëtare për prezentimin dhe afirmimin të komunës tonë.
- Digjitalizimi i Bibliotekës të qytetit të Hanit të Elezit,
- Përfundimi i investimeve në memorialin Bllaca 99,
- Përfundimi i parkut “Isa Berisha”,
- Përfundimi i rrugës “Paldenicë-Lagjja Ramuk”,
- Rikonstruktimi i urës së Seçishtës.

Tani, unë do të ju kisha lutur që edhe ju t'i bashkangjiteni këtij debati publik , të na jepni vërejtjet dhe këshillat tuaja si dhe propozimet tuaja, me qëllim që ne të mund të përmirësohemi në vitin e ardhshëm qeverisës. E hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Naser Laçi:** Unë kam dy propozime. Një ka të bëjë për te vendi Laç, te pjesa e varrezave, nuk është projekt shumë i madh, por po kemi problem me automjete kur po kthejmë, s'po ka hapësirë edhe vështirësohet qarkullimi, kështu që kisha propozu që të futet në plan zgjerimi i kësaj rruge. Kurse propozimi i dytë, ma saktë shqetësim, te çerdhja nuk e di a ka dysheme aponxemje, por po është ftohtë në sezonën e dimrit dhe me planifiku diçka për këtë çështje për 2023-të.

**Mehmet Ballazhi:** Porjekti për zgjerim dhe shtrim të rrugëve, e kemi në vazhdimësi dhe mund të jetë edhe rruga te Laç, gjithashtu edhe te çerdhja ne po bëjmë përpjekje që të jenë së paku kushtet optimale dhe do të përkujdesemi edhe për çështjen e nxehmjeve.

**Ahmet Krasniqi:** Në debatet tjera publike, ne nga fshati Paldenicë kemi propozu parkun e fshatit dhe nuk e pash në planin tuaj, gjithashtu te projektet e arsimit, kisha propozu që me u largu projektorat dhe me vendos Smart TV, dhe si pikë e tretë kisha propozu që në fund të vitit me u stimulu nxënësit që tregojnë rezultate ma t'mira që të jenë shembull edhe për të tjerët.

**Mehmet Ballazhi:** Për çështjen e digjitalizimit të shkollave, ne kemi pas takim me KFOR-in dhe kemi mendu me fillu me 4 kabinete të informatikës me i vendos tabelat digjitale në 4 shkollat, e cila do të jetë si pilot projekt, sepse jo të gjithë mësime të kanë përvojën për përdorim të tyre, e më pas me mundësitë tona do të mundohemi me i pajisë të gjitha klasat me tabela digjitale. Kurse te rregullimi i parkut në Paldenicë, ne i kemi nda kategoritë buxhetore dhe i kemi paraqit si projekte gjenerale për krijimin e hapësirave gjelbëruese rekreative, kështu që mund të rregullohet.

**Natyra Kalisi:** Deshta me plotësu që debatet publike që jemi duke i organizu, për të gjithë ata që e kanë të pamundur të jenë fizikisht prezent, e kemi në dispozicion edhe “Meeting online”, por deri tani nuk është kyçur asnjë qytetar. gjithashtu kemi lënë emailat e Kryetarit dhe Nënkyetarit ku mund të japin, idetë, propozimet, sugjerimet, kritikak e tyre.

**Vait Daci:** Te objektiva e parë, a është edhe heqja e shpenzimeve për nxënësit që shkojnë në Ferizaj apo Prishtinë?

**Mehmet Ballazhi:** Aty është esenca, si target kryesor dsepse është një numër i nxënësve të shkollave të mesme që vazhdojnë shkollimin e tyre, edhe pse ne nuk e kemi obligim për ta, megjithatë ne duam që t’iu ofrojmë një zgjidhje, dhe kemi bërë përpjekje me linjat e autobusave, që së paku me kriju orare të përshtatshme për ta.

**Mehmet Ballazhi:** A keni edhe ndonjë diskutim për Raportin që u prezentua sot? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur Debatin publik.

Mbledhja përfundoi në ora 15:45.

**Procesmbajtësja**  
**Liridona Ballazhi**



**Kryetari i Komunës**  
**Mehmet Ballazhi**

